



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S S Ë X T Ë R R E G U L L T T Ë K U V E N D I T K O M U N A L T Ë K O M U N Ë S S Ë V I T I S Ë

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 31.10.2016 (E Hënë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, kryetari i Komunës z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit: Sami Demelezi, Zekrija Zuka, Nexhat Aliu, Xhilsime Qamili, Ali Bajrami, Adnan Imeri, Vjollca Kadolli - Halili, Nuredin Lutfiu, Ajtene Frangu, Bekim Azizi, Samet Idrizi, Taib Alidema, Hyse Rama, Visar Demiri, Bislim Bislimaj, Sejdi Emini, Baki Nebiu, Daut Xhemajli, Vjollca Sylejmani, Ekrem Abazi, Mirlinda Sadiku, Vehbi Rama, Majlinda Ostrogllava, Selvije Rexhepi, Besjana Rexhepi. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesja e Zyrës Ligjore, përfaqësuesi i Zyrës për Integritet Evropian, mjetet e shkruara dhe elektronike, ndërsa në mbledhje mungoi Arbresha Ibrahim.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardh në seancën e X të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes Kryetarin e Komunës, z.Sokol Haliti, Nënkryetarin e Komunës, z.Hasan Aliu, juve të respektuar Këshilltar komunal, Drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, mediat e shkruara dhe elektronike dhe të gjithë të tjerët që janë sot prezent, dhe para se me fillu me punimet e Kuvendit, unë kisha dashur ta falënderoj shoqatën "Vitia", për organizimin e një aktiviteti në Zhenevë, me karakter humanitar, në të cilin eveniment isha prezent së bashku me kryetarin e komunës. Karakteri i asaj mbramje ka qenë, që të mblidhen ndihma për familjen të cilat janë me nevojë dhe në varfëri të skajshme, për ndërtimin e shtëpive të ndryshme. E po shfrytëzoj rastin, si kryesues e në emër të juve, ti falënderoj të gjithë ata mërgimtar tanë për kontributin dhe sakrificën që po e bëjnë për me ju dalë ndihmë këtyre familjeve në nevojë. Më lejoni të ju informoj, se Zyra Ligjore e Ministrisë se

Administrimit të Pushtetit Lokale, na ka konfirmu ligjshmërinë e akteve, të cilët i kemi nxjerr ne si Kuvend Komunal në seancën e fundit dhe ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë.

Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, nëse ka dikush të parashtrij pyetje ose propozime, fjala është për ju, urdhëroni.

znj. Mirlinda Sadiku: Përshëndetje për te gjithë të pranishmit,. Pasi që qenka kryetari këtu, kam një pyetje për këtë, për taksistët tek rruga "Kemajl Azizi". Aty kryetar të kame pa dy tri herë, je ndal ki bisedu me taksistët, ke dëgju shqetësimi e tyre. Po me intereson ta di: A do të shtrosh atë shtojcën andej, që është tu rregullu ajo pjesa e argjinaturave të lumit "Morava", sepse me sa është thënë nga taksistët, ata kanë thënë, se nëse na largojnë na këtu, ne do të dëmtomi ekonomikisht. Ne e dimë që ata majn familje. Do të ishte mirë, që tek e fundit të bëhet edhe një aneks kontrate, që të ju bëhet një zgjidhje përgjithmonë këtyre punëtorëve, sepse ata kontribuojnë në buxhetin e komunës. Po ashtu me rastisi një ditë tek një informatë të dhen nga televizioni plus, se ka ankesa nga banoret e rrugës "Safet Rexhepi" dhe rrugës "Skendet Salihu", dikun rreth 400 metra është një rrugë aty, e për te cilën ata kane ankes, qe nuk është shtruar me asfalt a parashihet këtë vite apo vitin tjetër.

z.Samet Indriz: i nderuar Kryesues, kryetar, koleg asamblist, Drejtor ekzekutiv dhe ju të pranishmit, përshëndetje! Pasi që janë duke u shtruar shume asfalte në Komunë të Vitisë, nuk po paragjykoj ne cilësinë e asfalteve, shpresoj që te bëhen mirë. Tash për momentin janë tu ba disa riasfaltime në Viti, disa kane përfundu e disa janë në procedurë e sipër. Është mirë që asfalti të gërryhet me shumë se në disa rrugë, niveli i asfaltit që është ka bëhet e ka arrit nivelin mbi trotuarin ekzistues, kjo është shumë keq edhe për sigurinë e qytetarëve, por edhe për estetik, se trotuari me se pari bëhet për me bë sigurimin e këmbësorit edhe për estetik ka një efekt. Kryetar, për vitin e ardhshëm kemi kërkesë prej qytetarëve, por edhe unë si përfaqësues i qytetit të Vitisë, se shumicën e votave i kam prej qytetareve të Vitisë, që të kihet parasysh ndërtimi i kanalizimeve këtu në Viti. Unë i kisha përmend vetëm dy rrugë, rruga "Hafiz Alikorça", që i ka mbi 50 shtëpi, nuk ka kanalizim, nuk ka as asfalt; rruga "Elvi Demiri", po ashtu nuk ka kanalizim, janë dikun 42 shtëpi.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë sot po i ngris dy çështje. Te stacioni i autobusëve, jemi dëshmitar që është duke u ndërtuar një pompë e benzinës, dhe aty e kemi një petition të qytetarëve të asaj lagje. Tash a u kanë shumë e nevojshme aty, a i plotëson kriteret, po flitet që edhe objekti është në prone publike, cila është leja që e keni dhënë ju, se po marrë leje prej komunës, leje mjedisore nuk mundet me marr edhe leje tjera, se ne e dimë që për pompë të benzinës janë do kushte që i lëshon Ministria. Mirëpo, janë kanë do leje, që këtu duhet me i marr. Besoj që na njoftoni pak me hollësisht, sepse është shqetësuese kjo pompë e benzinës, që është duke u nderuar te stacioni i autobusëve. Pyetje tjetër, qeky investitori Gjerman, që i paralajmëroj nja 500 vende të punës, begi shumë i keni dhënë jehon ne media, tashti po ndegjomi, që ai u terjek, po dëgjojmë se ai u kushtëzuar prej ketuit e forma të tjera. Po kërkojmë një informatë me zyrtare me naj dhanë prej pushtetit, është e arsyeshme.

Kryetari z.Sokol Haliti: I nderuari kryesues të respektuar këshilltar të Kuvendi Komunal, përfaqësues të OSBE-së, ju të tjerët që jeni prezent, ju faleminderit për pyetjet të cilat u

parashtruan nga këshilltarët! Ishte pyetja për taksistët, vërtet them se Kuvendi Komunal e ka bërë një punë me të mirën kur e ka miratuar planin e mobilitetit, ku hinë edhe vendet e taksistëve, shërbimet e tjera për qytetar. Është bërë një hap i madh drejtë rehabilitimit edhe rregullimin e vendeve të taksistëve, do të vazhdojmë, i kemi edhe dy vende nga pak që mendoj se atje ku e ceke ti znj. Këshilltare, është hapësira tjetër e dedikuar edhe e rregulluar, bilem me ndriçim, por ata taksistë, disa nga këta kanë qejf me nejt aty shume afër rrugës, se ajo hapësirë është e dedikuar për tjetër sen, edhe për taksistët kombi që janë te stacioni, te pjesa tjetër kanë nevojë me u rregullu, po besoj që shpejt do të bëjmë zgjedhje edhe për ta. Sa i përket rrugës "Safet Rexhepi" e rrugës "Skender Salihu", me u shtriu me asfalt, është me të vërtet nevojë e kohës, që rrugët me u përfundu, janë nevoja të qytetarëve, besoj qe këto rrugë janë në proces, nuk kemi më shumë mundësi se sa kapacitetet buxhetore, por projeksioni i ri është edhe ne do ti plotësojmë aty ku kemi mbet keq. Unë besoj qe do ta bëjmë një rrumbullakosim edhe me vitin e ardhshëm 90% të rrugëve dhe lagjeve, do ta bëjmë nivel të komunës dhe do ta shikojmë bashkë. Riasfaltimet në Viti, natyrisht një projeksion i cili është një buxhet në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës përfshin edhe rrugën e Stubllës, përfshinë edhe një pjesë të madhe të disa fshatrave edhe disa rrugë të lagjeve, që kane mbet keq, përfshin edhe rrugë urbane ne viti, megjithatë e kemi një disproporcion të trotuareve ekzistuese me asfaltet, për shkak se edhe ashtu është mendu ne projeksionin, është be edhe sheshi qe natyrisht mu ngrit shtresa, bilem janë edhe vijat e vizatume, ingjinerat natyrisht e dine shumë më mirë, në këtë kuptim do të shikojmë, do të ju rrim gati, unë mendoj që duhet mu rrumbullakesu mu kry njëherë, tani masanej mundemi me debatu, me i pa të metat dhe përparësitë, e ku unë mendoj që 99% ka me qenë përparësi kur te rrumbullakoset edhe sinjalistika edhe te gjithat te tjerat, edhe horizontale dhe vertikale, ka me qen një petk i ri, që vërtet ka me bërë nderë Vitisë dhe gjithë neve. Te kanalizimet, 11 kanalizime janë bërë në viti prej që ka ardh kjo qeveri, prej Sodovinės së Çerkezve, Tresteniku, Germovë, Gushicës e fshatra të tjera, 11 kanalizime te reja jashta atyre që kane qenë në gjysmë, me këta që kanë qenë ne gjysmë jemi mundu me i kry, nëse ka naj të met ende kemi me i përmirësu, p.sh.: në Terpezë kemi bërë përmirësime në këtë javë, do të shikojmë edhe ne fshatin Smirë, por kem probleme, edhe para 10 vite si ne Remnik, Skifteraj etj, por jemi tu dashtë vërtet me i rregullu, edhe besoj që kemi me i rregullu me një projeksion me lloto, dikun 17 lloto i ka projeksioni i ri i rivitalizimit të kanalizimeve ekzistuese, që përfshin lagje edhe në Viti, por, tash nuk po muj me të than saktësisht cilat lagje, por, e di që nja tri katër lagje janë në Viti, si lagjja te ambullanta, lagjja të "Sherif Frangu" e disa lagje të tjera, kemi edhe ne Pozheran te ambullanta, nga lagjja "Korrani", kemi në Skifteraj etj etj. Te stacioni i autobusëve, pompa e benzinës, leje të shtëpisë ka pas ai, se e kemi shiku, leje për pompë nuk jep komuna, për kushtet të sigurisë jep Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Tregtisë dhe digaster të tjerë. Ne bizneset e tona nuk i ndalim, nuk i bllokojmë, nëse ka kushte të sigurisë, pompa ka edhe ne Njyjork, por kushtet e sigurisë duhet ti ofroj, ato janë çështje që duhet te merren dikasteret përgjegjëse. Te investitori Gjerman, kam dal në fotografi është e vërtet, për shkak se unë kam incistu, që investitorët me i pru në komunë tonë, prej 11 komunave kam arrit investitorin

gjerman me e prunë në Komunë të Vitisë, e ka zgjedh Vitinë, se ne vërtet i kemi ofru kushte me të mira, kemi qenë me atraktiv apo kemi krijuar ambient biznesi dhe siguri, Vendi i biznesit në Viti është me zero korrupsion, unë edhe para një ore u takova me delegacioni gjerman, ku kanë ardh edhe te tjerë, isha në vend të ngjarjes, mund t'i vizitoni edhe ju, prandaj, investitori është këtu dhe janë ka përgatiten, unë qyshe i pash sot kanë me shku përpara.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit Kryetar, për sqarimin që dhatë rreth pyetjeve të parashtruara nga ana e këshilltarëve, dhe deklaroj që në seancën e X të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë, kemi paraparë këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Kuvendit Komunal të Vitisë.
2. Njoftim – Debat për kycjen në autostradë.
3. Pasqyrat financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-shtator 2016.
4. Propozim vendimi për shpalljen në diskutim publik, për propozimin e planin e mirëmbajtjes dhe planit investiv të hapësirave të hapura publike në Komunën e Vitisë.
5. Propozim vendim për hapjen e shqyrtimit publik, për planin rregullues të hollësishëm dhe vlerësimin e strategjisë mjedisore për zonën ekonomike me statusin park industrial.
6. Propozim vendim për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm parcelat në zonën kadastrale në fshatin Sllatinë, të cilat parcela gjenden nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
7. Propozim vendim për ndryshimin e vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
8. Informatë për auditorin lidhur me raportin e vitit 2015.
9. Informatë nga DKA.

A ka dikush rrethe rendit të ditës ju lutem? Pasi që nuk ka, unë e kam një propozim, që piken numër 5, propozoj ta qesim si pikë të tretë të rendit të ditës, për faktin që është pikë që nuk e kemi pas në KPF, mirëpo me insistimin e kompanisë implementuese të këtij hartimi të projekti dhe për zënien e afateve e cila po na duket pak e shpejt dhe me e miratu vitin e ardhshëm, kanë propozu që te vihet në Kuvend të miratohet, në mënyrë që ta merr vizën nga Kuvendi që të dal në diskutim publik. Kush është për këtë rend të ditës dhe për ndryshimin e pikave të rendit të ditës që propozova unë? Ju lutem me ngritje dore.

z.Daut Xhemajli: Përshëndetje Kryetar, përshëndetje për të pranishmit! Mu qekjo pika që po ngutemi, mu po me doket pak jo normale, nëse është dashtë mu ngut, u dashtë mu ngut ata që me naj prunë KPF, nëse është puna e ngutjes se tyre pa ardh në KPF, pa u diskut, nuk është mirë na me i thy proceduat e me e qit në Kuvend, nëse ka naj arsyeshmëri të madhe, atëherë Kuvendi le te vendos a me shti pa kalu në KPF këtë pikë a jo, propozuesi e arsyeton, dhe Kuvendi duhet me vendos për këtë pikë a me shti pa kalu në KPF apo jo.

Nenkryetari z.Hasan Alia: Përshëndetje Kryetar, Kryesues e ju te pranishëm të tjerë! Mos ta keqkuptoj këtë, por krejt qëllimi jonë është që në janar të kompletimi rreth dokumentacionit, se nga mendimi i juaj sot, ky do të jete për një muaj në diskutim publik dhe krejt kjo kemi llogarit që në dhjetor ky duhet të na kthehet si dokument për shqyrtim në Kuvend dhe ta merr vizën pro, që në fund të kompletimi me dokumentacionin për aplikim për zone ekonomike, prandaj, kemi

konsideru, që me mendimin e juaj që do ta jepni sot, konsideroj se është një çështje e cila mund të kalohet, Kuvendi ka kaluar edhe vendime të tjera pa kaluar në KPF, prandaj, për shkak krejt të afatshmerisë të cilën duhet ta nxëmë, që është interes i përgjithshëm për Komunë të Vitisë.

z.Daut Xhemajli: Problemi është që ne duhet me pas një material, që ky Kuvend e miraton dhe e qet ne diskutim publik, paraprakisht na duhet me pas një material që e kemi diskutu, e ku ne nuk kemi material për këtë. Unë nuk e di kush ka material këtu, për këtë nuk po di qyshe me diskutu kur nuk e kemi materialin.

Kryetari z.Sokol Haliti: Kompania projektuese që e ka fitu projektimin dhe plani që e ka bërë sot, Kuvendin është tu e informu para se me dal në debat publik, ta dëgjojmë kompaninë të na njofton rrethë planit, mos e merrni si insistim që po dojmë ne, por, kjo është në interes të përgjithshëm, nëse do Kuvendi me e ndëgju kompaninë, me bërë prezantimin mirë, nëse jo e lëmë për seancën e ardhshme.

znj.Vjollca Kadolli-Halili: Përshëndetje për Kryetarin, për te gjithë të pranishmit! Ne si grup parlamentar jemi pro që te jetë kjo pikë në diskutim, pasi që do te del ne dëgjim publik e do të njoftomi edhe me gjerësisht.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pas këtij diskutimi e qes ne votim këtë rend të ditës me këtë propozim që e thash me parë: Kush është për këtë rend të ditës dhe për ndryshimi e pikave të rendit të ditës, që propozova unë? Ju lutem me ngritje dore. Konstatoj se me 13 vota pro dhe te tjerët apstenuan hinë si pike e rendit të ditës me propozimin e dhënë.

Pika e parë

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Kuvendit Komunal të Vitisë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rrethë procesverbalit: A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? Pasi që nuk ka, po e qes në votim për miratim: Kush është që miratohet pika e parë e rendit të ditës, konstatoj që me votat e të gjithë të pranishmeve u miratua pika e parë e rendit të ditës.

Pika e dytë

2. Njoftim – Debat për kyçjen në autostradë.

Është një pike e cila është kërkuar nga ana e disa këshilltarëve komunal, përkatësish nga partitë politike, ja japë fjalën Kryetarit z.Sokol Haliti të na njoftoj me gjerësisht për këtë pikë.

Kryetari z.Sokol Haliti: Faleminderit për fjalën, po shfrytëzoj rastin të ju njoftoj për këtë pikë shumë të rëndësishme, që me te drejtë e keni ngritë, por duhet ta dimë ne fillim që kjo është kompetencë e nivelit qendror, edhe një autoudhë që është nënshkru kontrata në 2011-të, besoj që e keni parasysh se tash e një vite kryetari i komunës me krejt kapacitetet me letra me takime zyrtare bënë përpjekje që vërtet me i siguru alternativ dhe qasje sa me të letë sa me te mirë komunës tonë, për shkak se ne e kemi detyrim si institucion dhe jam i interesum edhe personalisht, që me të vërtet, por, gjithë një duke marr parasysh konfiguracionin e Vitisë që shtrihet në dy magjistrale dhe natyrisht pjesa e Budrikes që kalon nëpër Pozharan e Ramjan ka qasje te Natyrali, ndërsa me i siguru pjesës tjetër që nga Stublla deri ne Sadovinë qasje dhe në këtë drejtim ne jo që nuk kemi bërë hapa po kemi bërë, unë e di që një pjesë e mirë e juaja është e njoftuar për shkak se kanë qenë takimet transparente edhe dokumentacioni që e kemi e kemi dorëzuar pranë ministrisë se infrastrukturës, e ku kemi pas takime edhe ne nivelin me të lartë dhe ne tash për tash e kemi një mirëkuptim me Ministrinë e Infrastrukturës, të cilën e falënderoj edhe për investime dhe përkrahjen që i jep për Komunën tonë, rivitalizimi i magjistrals prej Gerlicës-Kllkot-Bibaj, d.m.th ka qenë hapi i parë i vërtet. Ne pas shumë decenieve e kemi siguruar dhe natyrisht po bëhen edhe aspekte të tjera që po na ndihmojnë shumë në përmasimin e

infrastrukturës, ndërsa na ka mbet qeky segment, por për mu nuk është vetëm ky segment, për mu është e rëndësishme shumë zgjerimi i magjistraleve, magjistrale Kllokot-Gjilan, që ka kaluar dhe është një projekcion me katër korsi, por edhe Kllokot - te Resturanti "Natyrali", se aty është qasja, tash për tash e kemi arrit një mirëkuptim, që me kriju një rrugë alternative për kyqje të letë, e cila mund të them që është si propozim e deri sa të behet kyqja me e thjesht ajo në Gerlicë, e kyqje alternative për udhëtimin Prishtinë – Tiranë, aty të "Natyrali" që i bien prej Sadovine së Jerlive dhe del në Sejevë, një kyqje një rrugë që do të jetë e zgjeruar 6 metërshë enkas për këtë aspekt, dhe që do ta përfshin territorin e Vitisë, por natyrisht me një zgjerim që do ta bëjmë që nga Vitia dhe askepti tjetër i zgjerimi që do të bëhet me projekcionin e magjistrale tjetër, vërtet jami inkurajus aspektet që ministri është ka i ofron komunës së Vitisë, në këtë rast se është një qasje, por ne po punojmë që edhe qasja tjetër të jetë ajo që po e kërkojmë. Të gjithë bashke do të insistojmë në mënyrë të kulturume, por shumë të vendosur, që kjo qasje vërtet të behet, se tash për tash e kemi te fusha e pajtimit, ndërsa qasja alternative na ka ofru, ne kemi dorëzuar dokumentacionin dhe besoj shumë profiti i kësaj qasje është shumë i madh, nëse arrim me e zgjeru magjistralen dhe me i kriju qasje drejtpërdrejtë ne vijën, e kam fjalën për Prishtinë - Tiranë, e vija tjetër është për Shkup, natyrisht është qasje që vërtet neve naj zhvillon edhe vendbanimet, me se dhjetë fshatra dhe natyrisht ju e dini që kemi propozu edhe nga Kuvendi komunal edhe çështjen e zonës ekonomike, lloves dy, atje ku po bëjnë përpjekje edhe sot do të kemi debat edhe për pronat e tjera dhe aspekte që neve na ndihmojnë, dhe krejt këto do të lidhen dhe Vitia do të jete ne mee te dy autostradave, një lidhje e shkëlqyeshme me një magjistrale të zgjeruar, që unë po them që dikund katra dikune tri kursi, do të jetë vërtet funksionale dhe atraktive edhe për bizneset, kështu që, në këtë drejtim jemi tu punu, tash për tash i kemi premtimet, ndërsa po punojmë edhe për qasjen tjetër, që natyrisht unë së pari si kryetar komune jam tu insistu, e di që edhe ju si Kuvend dhe krejt partitë politike, se krejt e kemi interesin e qytetarëve të Vitisë.

znj.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje për Kryetarin, Nënkryetarin e ju te pranishëm! Autostrada, është be që tri vjet shume zhurmë, edhe mirë që është be shumë zhurmë, edhe pse Vitia me mete zorr qorre përgjithmonë pse, sipas planit komunal që është miratuar në vitin 2010, që parashihet deri ne vitin 2020, thuhet citoj: "sfidë është paraqit transporti i automobilistik dhe infrastruktura rrugore, lidhja e Vitisë me korridoret rrugore është sfidë, që duhet të trajtohet shumë seriozisht. Ne në bazë të planeve dhe projekteve qeveritare, do të planifikohet kyqja ne këto korridore rrugore, pse mos të kemi të drejtë, edhe ne Vitia i ka 46 mijë e 397 banorë, e dimë që kufizohet me Gjilanin, Ferizaj e Kaçanik, pse të na mohohet kjo e drejtë. Mu ma merr mendja, që as ekonomikisht, as politikisht, as ligjërish nuk është e drejtë. Pse e thamë këtë, se ekonomikisht Vitia e ka token me te mirën në Kosovë, më bonitetin më të mirin, e ka konfirmu drejtori i Bujqësisë. Vitia është, d.m.th prodhuesi më i madh i grurit në Kosovë, Vitia ka d.m.th kapacitet për zhvillimin e bujqësisë, ne e dimë që 30% e popullsisë merret me bujqësi, pse te na mohohet kjo e drejtë, qasje në autostradë, qasje në treg, shume më shpejt kur dijet që kosto e udhëtimin është shumë më e ultë, nëse kemi qasje më të shpejtë ne autostradë. Politikisht të gjithë kanë bë zhurmë, përpos juve si kryetar, keni përdorë forma të ndryshme, po mundoni mi thanë jo, humbe një donacion në qoftë edhe 100 mijë euro një asfalt leje pa u shtru, ama mos ti paguajmë pasojat ne si qytetar të Vitisë, që ne 10 vitet ose 20 vitet e ardhshme masi të kemi kyqje në autostradë, na jemi pro që te kemi kyqje në autostradë, tek e fundit Anamorava është kontribuuesi më i madhe ne buxhetin e Republikës së Kosovës, ndërsa sa i përket ligjërish, unë mendoj që është cenim dhe shkelje e të drejtave të njeriut.

Kryetari z.Sokol Haliti: Anëtarët e KPF-së, Kuvendi Komunal, Qeveria e ju këshilltar, ne jemi persona publik dhe politik, kur të flitet për kryetarin, kemi të drejt të flasim edhe për anëtarët e

Kuvendit, kur kryetari kritikohet ka të drejt të kritikohet edhe këshilltari, kur ti jepet vërejtje për drejtorin, vërejtje mund të jepet edhe për këshilltarin, kjo është demokraci. Nëse unë nuk jam tu u angazhu për kyçjen në autostradë, je shume gabim, por unë jam ka ta them formën e kompetencave që e kemi, kjo është kompetencë e nivelit qendror, por unë nëse pajtohem e ngritmi zërin ne emër te krejtve, edhe pse duhet mu pajtu që e kame ngrit qe gjashte muaj edhe me letra e me takime. Ju bane një deklaratë të përbashkët, unë i pari e nënshkruajë, dhe e qojmë, është përforsim, është alibi për mu dhe tash po ju them që do ta kemi në debat ministrin e Infrastrukturës dhe urdhëroni shefat e grupeve parlamentare, me qenë me mu bashkë me fol për autostradë, ministri bashke me kabinetin e tij do ta kemi shume shpejt ne Viti dhe e kam ftu, i kam dërgu letër, e ka pranë debatin dhe do ta kemi në debat shume shpejtë.

z.Bekim Azizi: Kyçja në autoëstrad me kalue një rruge magjistrale e mos mu lidh në autostradë edhe që përfshihen një numër i madhe i banorëve, që përfshihen disa komuna, unë mendoje që nuk është e mirë, kur tham nuk është e mirë, e di që nuk është tu e bë këtë niveli komunal, por është nivel i projektit. Unë mendoj që duhet me u kanë krejt të një zëri, është interesi i vendit, është interesi i kyçjes se qytetarëve, është çështja kryesore që na lidh me pjesët e Maqedonisë, që është komplet një pjesë e madhe e zhvillimit, që hinë prej kufirit në Elezhon. Unë mendoj që nuk duhet të lejojmë në asnjë mënyrë, me gjithë forcat tona, me të gjitha mundësitë që i kemi ligjore, me gjithë presionin tonë politik që e kemi si pushtet dhe ne si opozitë, që të na kalon kjo çështje pa u kyç na në autostradë. Unë mendoj që ne asnjë formë nuk duhet të pranojmë alternativa tjera, alternativa të tjera në fund pasi te kryhet autostrada na pa qare kemi me pranë alternativa, alternativa nuk duhet te pranojmë, në këmbim te sajna, unë mendoj, dhe kam një propozim prej grupit tonë parlamentar, që të behet një harmonizim i qëndrimeve, të bëhet një deklaratë e përbashkët e Kuvendit, përmes kryetarëve të grupeve parlamentare, le të bëjnë një të përbashkët, le të sjellin këtu e le të ju drejtohen Qeverisë prej Kuvendi prej institucioneve që i kemi, ky është qëndrimi i grupit tonë.

z.Daut Xhemajli: Unë mendoj që duhet debat, qe së pari ne si përfaqësues te qytetarëve të komunës son me na u mush mendja, që Vitia e ka domosdoshmëri ose është e domosdoshme kyçja e Vitisë në Gerlicë. Në këtë kuptim, këtij Kuvendi duhet me ju mush mendja e me pas te kjart këtë, se ka mundësi, që qytetarët ende nuk e kane te kjart, se qytetarët e Vitisë duhet mu kyç te fusha e pajtimi edhe në Sojevë. Unë mendoj, që ky Kuvend ka qenë dashur me i thirr edhe ekspertet të tjerë me ndegju, me e arsyetu këtë kërkesë e këtë domosdoshmëri tonën. Çka kanë ba institucionet, e tha kryetari, e çka duhet të bëjmë të gjithë na bashkarish, qoftë pozitë apo opozitë e individ të tjerë, me e nimu edhe institucionalisht, që kjo kërkesë me u realizu. Unë mendoj, qe kemi përgjegjësi me e diskutu, nëse nuk behet kjo kyçje për Vitinë, unë mendoj që është një anashkalim i madhe ekonomik e politik, vazhdim i anashkalimit politik e ekonomik, izolim i 100%, edhe rritje e izolimit të Vitisë. Sa i kushton Qeverisë së Kosovës një kyçje në Gerlicë, na nuk jemi ekspert, nuk e dimë, nuk e kemi projektin, çmimin nuk e dimë, po po supozojmë që ka me kushtu nja 1 milion, cili është çmimi që e qytetarët e Vitisë kanë me pagu për nja 10 a 50 vjet, për mos kyçje në autostradë, me shume se 1 milion qind për qind për nja 10 vjet, por, disa milion për shume vjet. A e ka llogarit najkush se sa ju kushton qytetarëve të Vitisë kyçja dikun tjetër. Unë mendoj që dikush duhet me ditë, e u kane dash me e llogarit, se kjo rrugë për ne Sojevë kushton me kohë, me karburante me armotizim, me te gjitha, por, pak nëse kushton 1 euro në ditë, ose nëse Vitia i ka nja 70 ose 80 mijë banorë rezident dhe jo rezident, nëse 50% e këtyre nja dy herë kanë me shku në Prishtinë, ka 1 euro nëse e harxhojnë me shumë, llogaritne sa bëjnë. Mue me kanë dal nja 120 mije euro në vjet, por here 10 vjet, d.m.th një kyçje apo dy kyçje janë te arsyeshme ekonomikisht. Vitia domosdoshmërisht duhet me pas kyçje në Gerlicë,

nuk mundet me qenë kyçja e shtrejt, por, duhet me na tregu që sa kushton, ne kemi kërku me pas një takim me ekspertët e ministrisë, me naj mbush mendjen, pse nuk kemi kyçje, ndoshta kishin me naj mush mendjen, për ndryshe kjo është apsurt. Unë mendoj, që kjo kërkesë duhet të votohet këtu, një delegacion i këtij Kuvendi, qoftë me shefat e grupeve, me kryesuesin e kryetari, të sigurojnë një takim me ministrin edhe me kryeministrin, në mënyrë që këtë shqetësim na me e prezantu edhe me pa sa janë të gatshëm me e perceptu kërkesën tonë.

Kryetari z.Sokol Haliti: Brenga është e përbashkët, kërkesa është e përbashkët, unë e kam adresu edhe do t'i adresoj, do t'i adresojmë edhe bashkë, do ta takojmë ministrin desh në Prishtinë desh këtu ne tryezë. Ky ministër është për lavdata për investimet që i ka bë në regjionin tonë, por nuk është lehtë, se kontrata për këtë është e vitit 2011, e ju e dini si punojnë kompanitë ndërkombëtare, edhe nuk është e lehtë, se nuk duhet me marr të lehtë këtë çështje, se me qenë lehtë, unë sot bashke me juve e përfundoj me ministrin e tanishëm. Ne do te insistojmë ta bëjmë presionin tonë institucional, si nevojë e kohës, qytetaret e Vitisë e dojnë edhe në Gerlicë kyçjen krahas të tjerave, por duhet të pajtomi të gjithë, se Vitia është e ndamë në dy pjesë të magjistrales, jemi dy pjesë, por jemi një terësi.

z.Baki Nebiu: Përshëndetje për te gjithë, kryetari shkoj, por unë mendoj që është e gabueshme që u largu për punët e ti të tjera të komunës, pasi që konsideroj që asnjë punë për momentin nuk është me interes për qytetarët e Vitisë se sa diskutimi i kësaj çështje. Tjera që mu po me pengon, është mendimet e juaja drejtuar këtij iniciimi. E para është, që po mënoni që ka kahje politike, e që kjo nuk duhet me ndodh ne asnjë mënyrë, pavarësisht, po edhe nëse këtë kryetari përfaqëson te gjithë qytetaret e komunës së Vitisë, çdo kërkesë duhet ta merr parasysh. E dyta, çka me pengoj e kryetarit, është mendimi komod i një alternative tjetër i kyçjes ne autostradë, knena prej Sadovines në Sejevë, jo kjo është e gabume, ne në këtë autostradë jemi të diskriminuar qytetarët e Komunës së Vitisë, kjo duhet të kuptohet edhe jemi të pajtimi të gjithë, mënyra është se si duhet të bëjmë me shumë ne për mu kyç ne këtë autostradë. Sipas kësaj, është mirë me dhanë edhe një informatë në bazë të kilometrave, Komunës së Vitisë ju shtohen edhe 8 km për me shku në kryeqytet, d.m.th në fshatin Doganaj, atje te Fusha e Pajtimit, është 4 km në drejtim të Kaçanikut dhe 4 km knej, d.m.th ju shtohet edhe 8 km për me shku në Prishtine. Unë besoj që kryetari është tu mundu në çdo aspekt për mu kyç ne Gerlicë, por, nuk po pajtohem me mendimin që po e thotë këtu, që është komod për kyçjen në Sojevë, është e gabume. Sipas informacioneve që kemi, punimet momentalisht në këtë pjesë të autostradës nuk janë ndaluar për shkaqe të ndryshme, kjo neve na jep shancin që me e diskutu, me bë debat, që mu kanë të gjithë njëzëri, që me e shtru kërkesë për me pas kyçje në Gerlicë. Alternativa tjetër është e një grupi të injinierve dhe arkitektëve të shoqatës së Vitisë, te ura ekzistuese dhe ura që është ndërtuar tash për autostradën, është një lehtësim shume i madh për me pas kyçje në autostradë, ata e kanë bë edhe dizajnin, do ta lë ty nënkryetar këtë. Të nderuar koleg, sot duhet bashkarish të fuqizojmë kërkesën tone përmes një deklarate, që të ju drejtohem institucioneve qendrore, që ta kenë parasysh këtë shqetësim të qytetarëve të Komunës së Vitisë. Çdo alternativë tjetër nuk duhet me qenë e pranueshme për ne.

znj.Vjollca Kadolli-Halitli: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. E dimë që ky është një projekt nacional, pajtohem me Bakin që e tha, që kryetari e ka bë angazhimin maksimal për kyçjen ne Gerlicë, por, nuk pajtohem kur tha që kryetari po ndihet komod që mu lidh te Sojeva. Pse nuk po pajtohem, sepse jam dëshmitarë i asaj, se sa takime i ka pas me ministrin e Infrastrukturës, pikërisht për kyçjen në autostradë, pikërisht në Gerlicë. U tha, që kur u bë plani për 2010 është fole për infrastrukturën rrugore ne Komunë të Vitisë, pajtohem se ka qenë ashtu, sepse kam qenë asambliste në atë kohë, mirëpo duhet me bë dallimin në mes te rrugëve në infrastrukturën

rrugore, që ka qenë në 2010 edhe 2016, është një dallim 100% në infrastrukturën rrugore, edhe krejt kjo falë insistimi të këtij kryetari, të kësaj qeverie, në bashkëpunim edhe në koordinim me Ministrinë e Infrastrukturës, e cila mundet të them që e ka bërë maksimumin me përkrah Komunitetit të Vitisë. Megjithatë propozimin që e tha Dauti, takim me ekspertët, e ku edhe kryetari e cek, edhe unë jam që ta kemi një takim me ekspertë, që të kemi detale se si shkon, si ka me qenë me e letë për Komunitetin të Vitisë.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje për të gjithë! Këtë debat që po behet sot, unë e kam ngrit dikur para pesë a gjashtë muajve edhe u diskutu dikur dy tri herë, dhe sot po me vjen shumë mirë që po thuaja të gjithë u involvuan dhe e dhanë mendimet e tyre dhe qëndrimet e tyre. Unë mendoj, që çështja e autostradës është një çështje shumë e rëndësishme e Komunitetit tonë, nuk hup kurrkush e me shumë as nuk fiton kurrkush, me shumë humbës jemi të gjithë nëse nuk behet, e nëse behet fitues jemi të gjithë. Çdo alternativë është e dorës së dytë. Unë mendoj që me qenë të gjithë së bashku, kryetar e asamblist, e të gjithë, na shkon puna ndryshe. Po ta kishim ngrit këtë debat para katër a pesë muajve, sigurisht që do të ishim dy tre hapa para, nuk do të mendonim se çka do të bëhet si do të behet, po se paku do ta kishim të qart se çka do të bëhet, a do të kemi apo nuk do të kemi. Këto debate që po cekem me i majt me kryeministrin e me ministrin, ishin krye më herët. Unë kam thënë, kur nënkryetari edhe me ka akuzua me njëfarë forme, se shekullin XXI nuk është mirë me thanë Malisheva dy kyçje. Unë qëndroj prapa qëndrimeve të miya, mos me zgjedh mjet as formë për me e arrit qëllimin me pas kyçje në Gerlicë.

z.Bislim Bislimi: Përshëndetje zonja e zotëri! Dua ta jap edhe unë një kontribut për këtë çështje, edhe dua me cek një rast shumë të rëndësishme, strategjik që ka Vitia si vende për kyçjen e kësaj autostrade, përpos se lidhet Komuniteti e Vitisë me 46 mijë po thojmë na votues, sepse me diasporë i kemi dikur 70 mijë banorë. Unë mendoj që kjo autostradë e kishte lidhur Gjilanin me Kllokot, po jo vetëm këta, por atëherë ishte hap perspektiva që ta lidhmi edhe Gushicën e Kumanovën, përmes fshatrave Stubell e Stançiq dhe ta afrojmë Kumanovën si vendbanim që e kemi historikisht shumë afër edhe me afër se Gjilanin, por edhe ta kemi pastaj përfitimin për me lidhe Shkupin përmes Maleve të Karadakut me Vitinë, atëherë Vitia do ta ketë një zhvillim. Kështu qysh na vazhdojmë të bëjmë alternativa, gjithmonë kemi me pas alternativa e kurrë nuk kemi me pas zhvillim. Vitia e anashkalume për gjithë këto vite, duhet të mobilizohet dhe ta bëjmë këtë kyçje, sepse është strategjike për zhvillimin e Vitisë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Atëherë, ne po pajtohemi të gjithë si grupe parlamentare, si parti politike, ta bëjmë një deklaratë të përbashkët, po e votojmë në Kuvend. Unë ju kërkoj ta propozoni nga një anëtar, e ta formuloni një deklaratë të përbashkët, në mënyrë që ta votojmë. Unë ju falënderoj për diskutimi konstruktiv rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës u dakorduam të kemi:

2. Propozim vendimin për hapjen e shqyrtimit publik, për planin rregullues të hollësishëm dhe vlerësimin e strategjisë mjedisore për zonën ekonomike me statusin “park industrial”.

Meqen se e kemi edhe përfaqësuesit e kompanis të cilët kanë punuar në këte drejtim unë i kisha lutur që përmes programit kompjuterik poëer pointit të naj bëjn prezentimi e keti propozim vendimi.

Përfaqësuesja e kompanisë: Përshëndetje i nderuar kryesues i kuvendit e për ju të pranishmi unë jame përfaqësuesja e kompanis VizionProjekt e cila ka bërë hartimi e zonës ekonomike për të gjithë komune e Vitise zona ekonomike me statusin e parkut industrial, në hartimi e keti plani kemi pasur mbështetjen konstante të drejtoris së urbanizmit sikur se edhe të drejtorive të tjera në kuadër të komunës së Vitise të cilat vazhdimish na kanë furnizuar me informatat për të cilat ne kemi pas

nevoje, fatmirësisht vitia e ka të hartuar plani zhvillimore Komunale sikur se e dim me Ligjin e ri të gjitha planet e tjera që janë me të hollësisht duhet të bazohen te plani zhvillimore komunale, ne jemi bazuar pikërisht te ky plan për informata të cilat i kemi marrë si për gjendjen ekzistuese ashtu edhe në vazhdim kur kemi bërë hartimi me të hollësisht të planit, zona ekonomike me statusin e parkut industrial është parapara të jete në pjesën verilindore të komunës së Vitis ka sipërfaqe prej 15.5 hektar e cila për më gjerësisht prezentimi e bëri përmes programit kopmjuterik poëer point pasi e përfundoi prezentimi për pyetje dhe përgjigjeje janë në dispozicioni e juaj.

Kryesuesi z. Naim Pira: Faleminderit për këtë prezantim, hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta marrë fjalën dikush ju lutëm.

z. Samet Idrizi: E felemenderojmë prezentuesen kjo kompani ka ofruar alternative të bollshme e pash që është punuar qka ka qen për mu shqetësuese me fillim kur kemi biseduar në vitin e kalur për këtë qeshje shqetësuese për mua është qeshja e përmbysjes aty ku e përmendi përfaqësuesja e firmës unë ka që 12 vite që udhëtoj në atë rrugë Viti-Gjilan e me siguri mbi 10 her është përmbys nuk di tash ju sigurisht nuk jeni kompetent për këtë punë se sa kemi siguri aty që me bërë këtë investim kaq të madhe aty ka ndodhe deri në dy metra përmbysja këtu është një garazh e automjeteve edhe një shtëpi ato kanë qenë totalisht nën ujë ku pronari nuk ka mundur me shku aty me zhvillu aktivitetin e vet biznesor, unë personalisht nuk mund për punë që e ka në firma apsulitish nuk du me ndërhy por këtë unë nuk e përkrahi edhe nuk e kame për kra as atëherë kish qen ide me e mirë mu bërë një liqen aty ishte për shtat shumë.

z. Bislim Bislimi: Unë e përshëndes qdo iniciativë që kanë bërë këta dhe punë që kanë bërë këta, ata që ne mundem me e ndimë këtë ma marrë mendja nga kjo legjislacioni i ri për hartën zonale e humbe termini dhe zëvendësohet me arte zonale dhe nëse nuk konsultohemi me ligjin unë e di që tash kjo ndryshon me art zonale dhe është mirë me u konsultu me ligjin e ri, a sa i përket kësaj na kemi qenë kundë sepse aty ka pasë shpartie që ka mundur me u rregullu mënyrën të mrekullueshme për token me të mirë të bujqësis kjo po na ndodhe vetëm neve në Kosovë në këtë vend millet uriz.

znj. Mirlinda Sadiku: Unë jetoj afër atë lokaliteti edhe u potencu edhe një herë rrezikeshmeria dhe kërcënimi nga lumi Moravë me sa e kuptova skenarin e parë një paraqitje sofanalizen për ndoshta me iku te skenari dy e tre nëse ki mundësi një rikapulum cilat janë përparsit te skenari dy dhe tre.

Përfaqësuesja e kompanisë: Patëm pyetje për Legjislacionin e kemi konsultu legjislacionin dhe jemi përmbajt në pikëpikë sipas Ligjit të ri për planifikim hapësitor planet rregulluese kanë ra poshtë është e vërtetë hirerarkia është plan zhvillimore komunal, arte zonal tani sipas vendimeve të të njëjtës Ministri që e ka miratë ligji për deri sa nuk kemi arte zonale thirrmi në plane kapitale fatemirisht Vita është një nder të parët të qytetit që e ka funksional edhe shume të sakte plani zhvillimore komunale tek i cili ne jemi thirr për më planin rregullues të hollësisht, sa i përket pyetjes për skenarët të tre skenarët kanë shume ngjajshmeri me njëri tjetrin rrugët janë ato që bëjnë dallimin ndërsa kërcënimet e moraves që u cekën ja të njëjta si të skenari i parë dhe i dyti morava është prap problem, e vetma që mund të themë mangësi ka qen se tek skenari i tretë i kemi pasur parcelat shume të vogla te skenari i dytë i kemi pas parcelat shume të medha e kur te behet parcela shume e madhe ka me shume problematik për ndarje.

Kryesuesi z. Naim Pira: Pasi nuk ka pyetje të tjera unë po e hudhi në votim kushe është që ky propozim vendim të shkon për diskutim të më tutjeshëm nga 25 asambleist të pranishëm me 19 vota për shkon në diskutim të më tutjeshëm.

Kryesuesi .fillojmë me punimet e séances së masditës, ne me grupet parlamentare u dakorduar që ta bëjmë një deklaratë se bashku po shpresoj se jeni marrë vesh kush do të bëni atë deklaratë ishte qenë mirë të terhekni dhe ta bëni atë deklaratë në mënyrë që ta votojmë si kuvend.

Atëherë si pike të katert të rendit te ditës kemi:

3. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhen janar – shtator 2016

Ftoj drejtorin tam err fjalën rrethë kësaj pike të rendit të ditës

Z.Ibrahim Rama: Më lejoni që para juve të paraqes pasqyrat 9 mujorepra është fjala për pasqyrat financiare janar-shtator për vitin 2016 gjithënjë këto pasqyra financier është obligim ligjor të paraqiten para ju në kuvend për qdo tre muaj , mos me ju marr shumë kohë pasi materialin me kohë për pyetje aop ndonjë konsultim jam ne dispozicion të ju ndihmoj

Kryesuesi . Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

z.Sami Demelezi: Një obligim i drejtorisë së financave i kryer në kohë të duhur kon form ligjëve në fuqi dhe konform planifikimit që kemi bërë ne asambleistet për qka drejtori i drejtorisë dhe stafi i tijë e meritojnë një falënderim , qysh në faqen e par të pasqyrave financiare del në pah e dhëna se krahasuar edhe me vitin paraprak kemi trende pozitive edhe pse edhe në vitin 2015 e dim që e kemi përmbyllur shumë suksesshëm . të hyrat një rritje rrespektabël që do me thanë kemi ngritje prej 16.55% ndersa shpenzimet e buxhetit nga mjetet e alukuara janë 91.34% të dhëna këto që nënkuptojnë se qeveria komunale me të njejten periudhë të vitit të kaluar ka një ngritje edhe të të hyrave edhe në realizimin e shpenzimeve për projektet që ka planifikuar kur kësaj i shtohet edhe e dhëna tjetër se edhe sa i përket donatorëve në këtë vit kemi një ngritje rapide në vitin 2015 në nëntë mujor donacion kishte vetëm 35600 euro ndërsa tani kemi një trefishim të kësaj shifre do të thotë prej 109956 euro qka do të thotë se janë të dhëna të cilat nënkuptojnë se në këtë periudhë qeveria komunale në krye me kryetarin kanë pas një angazhim shtesë dhe ja kanë arritur që të kemi pasqyra jarzakonisht të suksesshme përqoka në tersi kjo qeveri meriton një falënderim për punën që ka krye dhe për të shkuar në faqe 20 që përmbillet me këto shifra : të hyrat e planifikuara janar – shtator 2016 janë 659655 euro , të hyrat e realizuara për të njëjtën periudh që po flasim 687677 euro që do të thotë prej 104.35% , dhe në fund mbetet që për periudhën e cila ka mbetur qeveria komunale ta realizoj 100% planin

z.Bekim Azizi: Periudha nëntë mujore e shpenzimit të buxhetit dmth është paraqitur që është obligim ligjor që të siellët para kuvendit , buxheti është i planifikuar por ka shumë elemente që nuk kemi planifikuar mirë kur krahasohen në detaje i shini shumë vlera që nuk ka shumë mirë të planifikuara kemi të planifikuar shitjen e masës drurore që është një shifër e madhe të hyrat janë zero për nëntë mujor qka shohë këtu një plan pozitivë duke i dhënë vretjtet përherë është investimet kapitale kësaj radhe te nëntë mujorshi është një rritje nuk është sikur në vitin e kaluar te subvencionet kanë mbetur begi shumë edhe pse e biseduam edhe atë ditë qe tri vite në qeveri një herë keni dhënë bursa për student për herë janë kanë të planifikuara kësaj radhe hala nuk i keni dhanë kjo nuk është mirë nuk di qa jeni duke bërë , shërbimet e ndryshme shendetësore kodi 13 430 na e dim që është kontrata me KARITASIN për ato shërbime me intereson sa është vlera që shkon nga ne për këto kontrata që janë 12-13 vetë sa shkon pagesë për këta , te shërbimet kontraktuese tjera është rritje pre 43 mijë ero që është kanë në nëntë mujorin e vitit të kaluar tash është 84624 euro edhe këtu është një shifër ku shihet një rritje shumë e madhe në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, edhe te mirëmbajtja e rrugëve lokale shihet një rritje nga 52 mijë në 62 mijë euro në periudhën e tashme , e shohë një rritje te kodi 14 210 reklamat dhe konkurset vitin e kaluar ka qenë 110euro për nëntë mujor kësaj radhe është rrethë 1800 euro do me than është një rritje shumë e madhe që nëse hymë në krahasim të vlerave të periudhës së kalume , megjithatë edhe drekat zyrtare mbi 19 mijë euro skam qare pa i përmend sepse është shumë , te rritja e të hyrave vetanake shifet një rritje që është për tu përshëndetur mirëpo un e shohë si pak të rrezikshme përshkak që u kanë një kushtëzim i qeverisë për shkak të

falëjeve të borgjëve që na i ka mundësuar kësaj radhe po mendoj se duhet me pas kujdes te të hyrat vetanake në periudhat e ardhshme që mos me pas ramje se biem keq .

z.Ali Bajrami: Pasqyrat financiare që i kemi për periudhën nëntë mujore janar – shtator janë të nxjerrura dhe të radhitura në mënyrën ma të mirë të mundshme ku jepen përshkrimet specifikimet për mënyrën e shpenzimeve deri në detajin ma të vogël nëse ndalim me i shiku buxhetin e aluduar edhe i shpenzuar na del një përqindje shumë e mirë e këtij buxheti të shpenzuar dhe që është për tu përshëndetur krejtë kjo në atë se në gjithë këtë buxhet të shpenzuar janë respektuar normat ligjore në këtë qka më bie në sy gjatë kësaj periudhe nëntë mujore është se kemi një rritje të hyrave vetanake në përqindje të shprehur prej 16.55% a duhet të jemi të kënaqur me atë jo por duhet të bëhet përpjekje ma të mëdha që të rritet kjo se kjo është një prej të hyrat që komuna mund të investoj aty ku ka nevojë por krahasuar me periudhën të njëjtë të vitit të kaluar është një përqindje e kënaqur , nëse hymë dhe i shikojmë shpenzimet e buxhetit duke filluar prej zyrës së kryetarit dhe në të gjitha drejtoritë përqindja është mbi 95% me prejashtim të drejtorisë për ekonomi dhe zhvillim dhe financa dhe drejtorisë së bujqësisë te drejtoria e ekonomisë ajo qka e bënë këtë përqindje ma të ulët është se pikërisht janë investimet kapitale që janë të nxjerrura vetëm për periudhën nëntë mujore a tash vetëm kemi hy në tetor kështu që me siguri janë ma të mëdha po ajo që është që duhet ti përkrahum dhe ti mbështesim se krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është mbërri një përqindje shumë e mirë dhe do të nxihen të gjitha afatet optimale që buxhet i planifikuar për projekte në kapitale të shpenzohet të ju afrohet 100% , mos me hy nëpër kode isha ndal vetëm te donacionet nëse e krahasojmë me vitin e kaluar kemi një ngritje mbi 304% është diku mbi 104 mijë euro që kemi të hyra nga donacionet , specifikimi i projektëve që janë krye gjatë kësaj periudhe janë të nxjerrura dhe të dhëna në mënyrë analitike të specifikuara dhe të detajuara në mënyrën ma të mirë të mundshme dhe në përqindje të realizimit të projektit për investime kapitale që është mbi 70% do të zihet afati optimal që brenda vitit kalendarik të kryhen të gjitha ato që janë të parapara , mirëmbatja e auto udhëve lokale që i kemi e kemi një shumë prej 62 mijë euro është mirë se rrugët janë duke u mirëmbajtur tu meremetua dhe janë qytetarët ata i prekin dhe i shohin të gjitha këto që janë duke u bërë për të mirën e tyre marrë në tërsi kjo punë nëntë mujore është një punë që është rrumbullaksua shumë mirë

z.Bislim Bislimaj: Edhe un desh ti them disa fjali rreth buxhetit dhe shpenzimeve që kemi bërë un frikoj se kjo rritje e të hyrave vetanake bëhet në komunën tonë kur nuk kemi zhvillim ekonomik nëse kemi zhvillim atëherë duhet me tregu ku janë ato soktor të ekonomisë që me mund me pas na tatime në pronë a qka po di un nuk jam ekonomist un po mundem me ditë 2 edhe 2 sa bajnë nëse nuk ka zhvillim ekonomik e në anën tjetër rriten të hyrat un po dyshoj se se ekemi masa të dhunshme konfiskim të pasurisë ose rritje të taksave gjoba gjykata policia randohen mbi popullin kjo nuk është metodë që duhet me veprua na duhet me fillu me zhvillim ekonomik pastaj me zhvillim ekonomik të sjellim të ardhura kjo është ekonomia që duhet me pas një shtet un besoj , për shpenzime kam kritikë sepse mendoj se kur i mblodha krejt ato derivate të naftës vike diku 28 mijë euro për 9 muaj për komunën tonë për kushte tona po më duket se është shumë për me krahasuar që është shumë e kisha dhënë një shembull perimetri i globit të tokës është diku 40 mijë kilometra nëse ne kemi shpenzuar 28 mijë euro naftë do të thotë se një makinë hecë me 10 litra naftë në 100 km i shtohet diku 280 kilometra kjo i bjen se na shtatë herë e kemi kalua krejtë globin e tokës deri në fund të vitit me siguri edhe nja dy herë e kalojmë atë .

Kryesuesi: Pasi nuk ka ma për të diskutuar ja kisha dhanë fjalen drejtorit se u shtra një numer i pyetjeve urdhëro drejtor.

z.Ibrahim Rama: Do të mundohem shkurtimisht , planifikimi jo i mirë un po e shpjegoj për të satën herë kornizat buxhetore i përcakton ministria e financave ata kufijt sa një komunë duhet me planifikua me grumbullua të hyra vetanake dhe pjesën tjetër e kompenson nga grandit qeveritar në këtë kuptim formohet edhe buxheti i secilës komunë në këtë rastë i komunës tonë në këtë drejtim ministria e financave na i ka caktua këto të hyra vetanake që duhet me i grumbullua për një vit na ja kemi arritur qëllimit sipas pasqyrave mjaft mirë un besoj dhe jam i besuar edhe te ju që se edhe ju mendoni njëjtë që të hyrat vetanake duhet me u rritë sa ma shumë se të hyrat vetanake shtohen është mirë , përndryshe në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik na të gjithë e dimë që politikatat makro ekonomike janë të nivelit qendrorë dhe jo të komunave dhe ato i kanë nivelin qendror për vete ne kërkojmë qka kemi mundësi kemi mundësi me krijuar ambientin të bërit biznes në ato taksa ku me ligj i takojnë komunës siq është taksa e biznesit kurse e vetmja taksë në një mënyrë që grumbullohet për momentin është taksa mbi tatimin në pronë , un jam duke përgatitur një plan në bashkëpunim me ju qka do të ndodh me taksën e biznesit kjo nuk do të ndodh në seancën e ardhshme po në seancat në vijim dhe na jemi duke punuar që këtë taksë me vazhdua si taksë e biznesit a edhe me tutje me lanë në këtë formë , subvencionet po janë të vogla në përqindje të realizimit un kam than edhe në KPF hala nuk është ekzekutua pjesa e buxhetit të subvencioneve për kredi të nxënësve edhe pjesa tjetër i takon drejtorisë së bujqësisë ata veq aludimin e mjeteve para disa dite e kemi shpërnda ata janë në fazën e shpërndarjes së këtyre subvencioneve dhe që nuk kanë hyrë në pasqyrat financiare bë nëntë muajt të këtij viti , kurse për pjesën tjetër të pyetjeve që i bëri Bekimi për kodin 13 430 është fjala për shërbime të ndryshme shëndetësore janë paguar 30 mijë euro është fjala për përkujdesin shtëpiak që e kemi marveshjen kryetari i komunës me KARITASIN Zvicerian pra vlera 30 mijë euro kurse pjesa tjetër prej 1375 euro përbën shërbimet e ndryshme shëndetësore dezinfektimin në arsim dhe shëndetësi , 13 460 edhe në KPF të njëjtën pyetje e keni bërë për shërbime të veçanta për kontrata shuma është 26580 euro kurse pjesa tjetër prej 60 mijë euro po e përbëjnë shërbimet kontraktuese tjera psh subvencionin i shoqatave të ndryshme dhe klubeve nga fondacioni i BE-së KROS BORDER në vlerë prej 28 mijë euro kontratat tjera pagat e punëtorëve të KROS BORDER-it 6 mijë e kështu me radhë kërkojmë kjo shumë përmban vlerë prej 84 mijë euro që në kuptimin e kontratave që i kanë nënshkrua Kryetari i Komunës , kodi 14 210 është fjala për reklamat dhe konkurset është fjala për 1766 euro tash si specifikim në kuadër të saj nuk e di qka u pagua kërkojmë por kjo shumë është e saktë dhe 14 032 e bëri pyetjen Bekimi është fjala për mirëmbajtjen e auto rrugëve ku shumën prej 31728 euro e përmban përmbajtja e auto rrugëve lokale pastrimi i rrugëve dhe sheshëve nga EKO HIGJIENA dhe shuma prej 31263 euro është mirëmbajtja e rrugëve dhe riparimi i tyre dhe pastrimi nga bora pra këto janë ato shuma që përmbajnë atë , 14 310 është për dreka zyrtare shuma prej 19054 euro e cila në vete përmban këto shpenzime dreka zyrtare për ditën e mësuesit shuma prej 2317 euro , dreka zyrtare të tjera në nivel të komunës kap shumën 12357 euro dhe dreka zyrtare për manifestimin e **FLAKADANIT TË KARADAKUT** kap shumën prej 4380 euro komplet kjo është struktura e këtij shpenzimi në fund ju falënderoj për pyetjet e parashtruara .

z.Baki Nebiu: Para se me fillua ma herët e kritikova Kryetarin që thash nuk është mirë me dal nga mbledhja kur ke duke fol për piken e rendit të ditës që patëm më herët nuk e kisha ndëgjue që ka pas një rast në familje kështu se nuk e kam ndëgjua dhe me vjen keqpër ta kërkoj ndjesë, tash po kyqem te pasqyrat financiare të them të drejtën prej kësaj pasqyre financiare përveq të rritjes së të hyrave vetanake kjo është pozitivitet kurse te ekzekutivi në shpenzime këtu konsideroj se te shpenzimet keni shpenzuar tepër dhe mendoj se përveq llusit dhe komunitetit të juaj pak keni bërë në aspekte tjera po ndalem në këto duke u bazuar në këto kode që i keni

sjell në kuvend , po ndalem te kodi 13 330 shpenzimet e udhëtimit brenda vendit duke marr parasysh se këtu janë cekur si derivatet si shpenzimet tjera që kanë ndodh pse është kjo shumë aq e madhe brenda vendit nuk po mundem me kuptua , tjetra pyetje pyetje që lidhet jashtë vendit është 6 mijë euro tish kanë Kryetari e kisha pyet që së fundi kam dëgjuar se ka qenë edhe në SHBA po du me pas një raport prej Kryetari se përse ka shkua atje dhe cili është rezultati i shkuarjës atje , tjetra pyetje është kodi 13250 dhe 13310 shpenzimet e telefonisë fikse dhe shpenzimet e telefonit mobil un e di këtu se komuna e ka një marrëveshje dhe krejt administrata mes vete e janë pa pare me fol nuk po më hy në krye si ka mundesi me shpenzua telefonin fikse në vlerë prej gati 6 mijë euro kur shumica prej neve e kemi pa pare me fol pra kjo shumë e telefonisë fikse po më duket shumë e madhe , tjetra e thash lluksit pasi po ju referona kodit 13 501 dhe 136 10 furnizim për zyre dhe mobile ku te dyjat këto bashkë bëjnë 75 mijë euro qdo raport të këtij buxheti vinë shuma të tilla un po konsideroj se me të vërtetë është bërë e tepërt, dhe pyetja tjetër është 14 230 shpenzime e informimit publik un e di se ju jeni shumë aktiv në fcb po tjerat shpenzime nuk i di kam qef mi ditë .

z.Ibrahim Rama: Në lidhje me pyetjet e fundit që i bëri z. Baku po mundona në pika të shkurtra është fjala për kodin e shpenzimit 13 130 ku përbëhet transporti i nxënsave ku përbën vleren prej 12497 euro dhe transporti i klubeve sportive dhe i shoqërive kulturo artistike në vler pre 1760 euro , kodi 13 140 shpenzimet zyrtare jashtë vendit prej 6751 duken si vijon : shpenzimet jashtë vendit të kryetarit të komunës 2571 euro transporti i shoqërive jashtë vendit 2761 euro shpenzimet jashtë vendit të DKRS-së 612 euro , shpenzimet jashtë vendit të drejtorisë së shëndetësisë 568 euro dhe shpenzimet jashtë vendit për bujqësi 238 euro komplet vlera është kjo 6751 euro dhe për shpenzime të telefonisë mobile kryetari për nëntë muaj ka shpenzua 401 euro dhe të gjitha telefonat tjerë mobil në kuadër të komunës është shuma prej 8927 euro dhe kodi 13 501 po është shuma 39420 euro po këto janë të shpërndara sipas shkollave shkolla e Vitisë 8600 , kuvendi i Lezhës 5600 , ambulanta në Pozheran 8500 ,zyra e kryetarit 1060 , shkolla Halil Alidema 7400 , furnizim me inventar në shkollen Njazi Rexhepi 7090 furnizim me inventar Kuvendi 100 euro dhe drejtoria e arsimit 960 euro pra kjo është struktura e hargjimëve, dhe 14 230 është fjala për shërbime për informim publik transmetimet televizive për seancat dhe aktivitet të tjera është 5753 furnizimi me gazeta ditore 315 euro dhe punimi i dokumentarit bashkëpunimit me BE-në vlera prej 27030 mijë euro .

z.Hasan Aliu: Desha të lidhem vetëm m pyetjen e asamblistit shpenzimet të lluksit se the un mendoj se duhet mu kanë i kujdesshem kur e thua un nuk e di por nëse na shkojmë me kerret tona në shpi dhe vimë ki qef me n a pa në këmbë thuj ta bëjmë atë kërkesë por ato janë veturat e tona dhe nëse thua na në Prishtinë po shkojmë me mbledhje me vetura na jemi obligativ me shkua se nuk mundemi me mbërri me autobus , e dyta që kisha me ta thanë se të vyenë me u korrigjua për vete , një po ta themë me sinqeritetë se unë marrë pjesë në mbledhje ne jemi komuna që kemi shpenzua më së paku .

z.Baki Nebiu: Faleminderit nënkryetar problemi është që mu korrigjua di vet ti vetëm mundesh me u përgjigjë kësaj liste që e pash un , sa i përket mobilëve ju mundeni asnjë herë me investua në komunë un po të tregoj që në qdo raport po më vjen 40 mijë euro mobile vetëm po dua me thanë se kjo mobile është lluks për mendimin tim tash kur ta specifikon ti mundemi me nga në tjetër mënyrë por kur e sheh mobile dhe lypi arsytim atëherë e jep përgjigjen tënde .

Kryesuesi: Po e përsëris edhe një herë janë pasqyra 9 mujore dhe kanë me na u përsëritë shifrat dhe natyrisht drejtori e specifikoj , sidoqoftë un ju falënderoj të gjithëve që dhatë kontribut rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Dhe si pikë të pestë të rendit të ditës kemi :

5. Propozim vendimi për shpalljen në diskutim publik për propozimin e planin e mirëmbajtjes dhe planit intensiv të hapësirave të hapura publike në Komunën e Vitisë

Ftoj drejtorin e drejtorisë përkatëse ta merr fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës

z.Ajet Sallahu: Ne kemi sjell një propozim vendim për shpalljen në diskutim publik për propozimin e planin e mirëmbajtjes dhe planit intensiv të hapësirave të hapura publike në Komunën e Vitisë puna rrethë këtij plani ka filluar në mars të vitit 2016 dhe janë formuar këto trupa këshilli koordinues ,grupi punues dhe grupi mbështetës , për mos me ju marr ma shumë kohë propozimin e material e keni para vete për pyetje përgjigje jam n dispozicionin tuaj

Kryesuesi: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

z.Nuredin Lutfiu: Një propozim vendim për shpalljen në diskutim publik për propozimin e planin e mirëmbajtjes dhe planit intensiv të hapësirave të hapura publike në Komunën e Vitisë, një plan i tillë është i nevojshëm për komunën tonë pasi se kam qenë pjesë e grupit punues për hartimin e këtij plani desh ati them disa fjalë rreth ecurisë dhe punës së hartimit të planit në fjalë. Gjatë kohës sa kemi qenë të angazhuar si anëtar të grupit punues së bashku me këshilltarin lokal nga DEMOS-i të cilin e falënderoj për angazhimin e jarzakonshëm që kanë dhënë gjatë gjithë kohës ne si grup punues kemi pasur parasysh që në këtë plan ti shënojmë gjitha hapësirat ekzistuese por nëse ndonjë hapësirë ka mbetur në emër të grupit punues kërkojmë ndejsë dhe pasi që është edhe diskutimi publik dhe do të merren parasysh edhe sugjerimet e juaja koleg, ky plan është hartuar në periudhën afatmesëme 2017-2021 në të ardhmën mund edhe të ndryshohet dhe të plotësohet , qëllimi i planit të mirëmbajtjes është qartas të definoj nevojat ,kërkesat dhe veprimet e qeverisjes lokale dhe departamentin përgjegjëse komunale për të mirëmbajtur hapësirat e hapura publike në nivelin standard të dëshirueshëm , ne si grup i LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim kërkoj edhe nga ju koleg-e ta përkrahni këtë propozim vendim.

z.Selvije Rexhepi: Unë dola këtu me qëllim se ky propozim ka me dal në dëgjim publik me i përmirësua disa gabime , un e analizova planin financiar ku parashihet implementimi prej 2017-2021 kur kalon në tabelen faqe pestë këtu parashihet kosto financiare për 2016 kurse v. 2017 nuk ekziston hiq ,ana tjetër është edhe diqka ta kaloj krijimi i planit inventivë për komunën e Shtimes ju lutëm është kjo një kopi paste apo është një diqka që është bërë një gabim pa dashje , ana tjetër edhe këtu një vlerë për investime kapitale që kërkohet një vlerë prej 1 milion e 519 mijë a vlera te investimet kapitale kur është hartua lista arrin deri te 500 mijë këtë kisha dasht ta shohin edhe një herë me qëllim që mos dalim keq para qytetarëve në momentin që del ky planifikim në dëgjimin publik kjo ishte ajo që desha të them .

znj.Vjollca Kadolli-Halili: Edhe un pajtohem që kjo të shkoj në dëgjim publik megjithatë mendoj se është një plan që është bërë mirë ku janë mbledhur shënime dhe statistika për hapësirat publike që në të ardhmën do të jenë bazë e mirë për punë dhe projekte të mira që mund të bëhen në tërë teritorin e komunës së Vitisë në përmirësim të hapësirave gjegjësisht zgjerimin e hapësirave gjelbëruese , është për tu përshëndetur mbështetja nga ana e DEMOS-it që na ushtë dhënë komunës sonë , megjithatë un kam një kërkesë po lidhem me lapidarin në Tërpezë që janë në oborr të shkollës dhe lapidari i Luftetarëve të Tërpezës në rrugën Molla Syla që shkon në drejtim të Qifllakut dhe menoj se ajo është harrua prandaj kërkoj që edhe ky lapidar të futet në procesin e mirëmbajtjes .

z.Sami Demelezi: Unë kam një pyetje për drejtorin : faqe gjashtë janë nja tri harta këtu njëra prej tyre ka një pikë të zezë qka nënkupton kjo nëse nënkupton komunën e Kllkotit atëherë pse nuk u korrigjua qajo vrejte në KPF .

z.Baki Nebiu: Sa i përket këtij projekt vendimi është një gjë shumë e mirë dhe që ju ka nevojit komunës së Vitisë bile në fakt këtë u e kam përmend disa herë që edhe në udhëheqjen e juaj ka pasur rregullime të parqëve po nuk ka pasur kush ti mirëmban kurse kjo është pozitive , kisha pas një pyetje për drejtorin Në Kabash poshtë shkollës është edhe një hapësirë gjelbëruese a do të hynë edhe kjo apo si i keni përzgjedhur parqet nëpër fshatra .

z.Beim Azizi: Unë mendoj se kjo është një nismë e mirë por duhet të plotësohet se ka mjaft vende që nuk janë të identifikuar këtu po e përmendi në Smirë lapidari 30 metra mendoj se është ma gjer aty , ose pllaka përkujtime janë edhe pllakat naltë që nuk janë të cekura hiq në Vorban vendi i ramjës së Kemajl Azizit nuk është e përmendur hiq pra ka vende që nuk janë identifikuar , një pyetje do ta bëjë te drejtori janë shumica e parqëve nëpër fshatrave që mirëmbahen nga fshataret që kanë do punëtor që i paguajnë tash do të na bëhet një ndeshje e mirëmbajtjes kompanis a kush do ti mirëmbaj një konflikt interesi mes atyre që mbledhin pare dhe që e paguajnë që i mirëmbajnë ata kjo mendoj se duhet të rregullohet dhe duhet të rregullohet edhe kjo çështje.

Kryesuesi: Pasi nuk ka për të diskutuar më kisha lut drejtorin u shtrua një numër i pyetjeve dhe janë lëshuar disa gabime është mirë që pas seancës të përmirësohen këto.

z.Ajet Sallahu: Unë desha të lidhem me këtë sepse na jemi duke kërkuar vetëm hapin e diskutimit publik ne nuk jemi duke kërkuar me aprovua sot prandaj gjitha vrejttet që bëhen edhe gjitha gabimet që bëhen nuk do të thotë që nuk kemi gabime se është një plan shumë i madh do të kemi diskutim publik prej ditës së aprovimit deri në ditën e aprovimit do të jetë në ueb faqe të komunës edhe do të jetë në diskutim me qytetar dhe kur ta sjellim draftin final do ti bëjmë edhe të gabime që janë lëshua .

Kryesuesi: Faleminderit drejtor un po e qes në votim që të shkoj kjo pikë e rendit të ditës në diskutim publik , konstatoj se me votat e gjithë të pranishmëve shkojnë për diskutim kjo pikë e rendit të ditës, si pikë të gjatë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim vendim për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm parcelat në zonen kadastrave në fshatin Sllatinë të cilat parcela gjenden nën menagjimin e agjencisë Kosovare të privatizimit

Është një pikë e propozuar nga këshilltari komunal Adnan Imeri dy seanca ma parë dhe natyrisht ne e kemi sjell para juve që të diskutojmë dhe ta miratojmë një propozim të tillë sepse në një mënyrë është në interes të qytetarëve të komunës sonë un po ja kaloj fjalën drejtoreshës rreth kësaj pike të rendit të ditës :

znj.Fatbardha Emini: Me lejoni të paraqes para jush parcelat kadastrave të cilat gjinenen në fshatin Sllatinë këto parcela për momentin menaxhohen nga AKP-ja dhe janë në pronësi të tyre për mos me ju marrë ma shumë kohë materialin e keni marrë me kohë për pyetje apo ndonjë sugjerim jam në dispozicion të ju ndihmoj

Kryesuesi: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës , a donë ta merr fjalën dikush

z.Adnan Imeri: Po dihet tash se e kam dhënë këtë propozim dy seanca më herët mirëpo nuk e kam dhanë vetëm sa me than por e di rëndësinë se janë nga ky fshatë , kjo hapësirë ka një rendësi të veçantë për banoret e fshatit Sllatinë por edhe për komunën e Vitisë andaj nga ju të ndëruar koleg kërkoj që ta votoni me qëllim që të ardhmën të mund ti procedojmë më tutje kthimin e kësaj pronësie në interes të përgjithshëm ashtu si e parashohin dispozitat ligjore .

z.Bislrim Bislrimaj: Unë frikohem se nga përvoja jonë q ë kemi pas me AKM-në dhe në Drobesh se i përkas atij vendi e kemi pas shumë veshtirë me u kuptua me ta sepse ata thoshin e vetmja komuna e Vitisë nuk i ka bë kërkesën për me i dhanë ato hapësira për me i marr në menagjim kur është kanë afati ligjor prej 5 viteve pas luftës nuk i ka bë ato kërkesa ndoshta edhe Dauti mund me na ndihmua në këtë aspekt se ka qenë pjesë e atij pushteti të asaj kohe , për ata e ngrita nëse na nuk kemi mundësi ligjore mos ta marrim ndonjë vendim që të dalim qesharak para tyre po të shohim se sa kemi mundësi dhe si kemi mundësi me i ndihmua fshatit Sllatinë rreth këtyre tokave.

Kryesuesi: E vetmja formë dhe e vetmja mënyrë për me mund me bë diqka është kjo që jemi duke e bërë sot , dikush tjetër a donë me marrë fjalën ju lutëm , pasi nuk ka po e hodhi në votim që të shkoj për miratim edhe kjo pikë e rendit të ditës : konstatoj se me vota të gjithë të pranishmëve kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës dhe si pikë tjetër te rendit të ditës kemi:

7. Propozim vendim për ndryshimin e vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Për këtë ja jap fjalën nënkryetarit që të najë paraqes këtë propozim vendim

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Të nderuar këshilltar para juve e keni propozim vendimi, shtytje e këtij propozim vendimi ka qenë se kryetari i KLSB nga Smira i cili ka dhën dorëheqje të pa revokueshme për shkak të shkuarjes në boten e jashtme e i kemi edhe dy ndryshime të tjera për këtë e kemi paraqit këtë propozim vendimi.

Kryesuesi z.Naim Pira: E hedhë në votim këtë propozim vendim kush është që të miratohet konstatojmë se me votat e të gjithëve u miratua.

Si pikë të tetë të rendit te ditës kemi:

8. Informata për auditorin lidhur me raportin e vitit 2015

Fjalën ja kaloje drejtorit të Financave

Drejtori z.Ibrahim Rama: Raportin lidhur me auditimi e pasqyrave financiare për vitin 2015 e keni marr sigurisht e keni analizua, sipas ligjit pasqyrat financiare për çdo vite auditohen nga zyra e auditorit të përgjithshëm për vitin 2015 kemi pas një auditim të këtillë un si ekonomist në shume elemente gjate kontrolles dhe pas kontrolles nuk jam pajtua me auditorte të cilët kanë qenë të caktuar nga auditori i përgjithshëm dhe këtë e kame bë transparente para te gjithë organeve. Për opinionin të cilën ne ka dhen për komune tone opinion i pa kualifikuar nuk kemi qen të kënaqur për shume arsyeje arsyet kane qen të gjetura materiale un nuk e kame pranua këtë raport të auditorit që nga sot e asaj dite nuk e kemi të pranuar zyrtarisht këtë raport, kem organizua një takim me drejtori gjeneral të auditimit me z,Besnik Osmani ne nga komuna e Vitisë e auditori që u kane i caktuar me kontrata për me na kontrollua dhe drejtori juridik ne zyrën e auditorët të përgjitheshe, dhe konstatimi i përgjithshëm ka qen qe vlerësimin për këtë opinion nuk është vlerësim që i përket situatës reale në komunës e Vitisë. Informatën e keni pranuar me kohe lidhur me raportin e v.2015, për pyetjet dhe përgjigje urdhëroni jam në dispozicioni e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rreth kësaj pike kushe e do fjalën:

z.Daut Xhemajli: Dua të filloj nga ajo që thotë drejtori se shkelje materiale nuk ka pas nuk u konstatua edhe në raporti e auditimin nuk kem konstatua unë nuk jam i bindu për këtë pune, mua me brengos çështja që na duhet me pas sistemi ton dhe a jemi tu e kontrollua a po jo edhe na a jemi të bindur që kur ata kanë thëna diqka dikune, shume vendi po thotë komuna ka proceset të llogaridhënies formale dhe raportimi por ka nevoja për tu ngritur dhe permisuar e po thotë që ju nuk jeni pajtu, un mendoj që u dashtë mu pajtu patjetër pse se na kemi dmth asi procese që formalisht mundet me qën procedura në rregull por nuk raportohen na kemi nevojë përherë mu përmirësu edhe na nuk e kemi rrit një shkallë që me qen asi niveli që mos mu

permisu. Thotë nuk është bërë zbatimi i tersishem i gjetjeve nga vitet i kaluar nuk janë zbatua edhe thotë struktura e komitetit të auditimit nuk është e pavarur thotë nuk jemi pajtua un e di që struktura e komitetit aj komiteti që e kontrollon auditimin është një e veçant nga to un e di që kane gabu por duhet me e nda nuk jemi pajtua se aj komitet është i pavarur por megjithatë të gjeturat që kane ndodh herëve te kaluara nuk janë zbatua se me u pas zbatua nuk ish dhen vërejtje. Thotë dosjen e personelit nuk mbahen ashti si që duhet a 100%, nuk jemi pajtua, nuk mbahen hiq e ju keni than që nuk jeni pajtua nuk e di pse keni than. Un mendoj që shkelje materiale nuk ka pas po procedura duhet me u rregullua që mos me ndodhe shkeljet, thotë komuna nuk ka krye pagesat brenda periudhës prej 30 dite thotë jemi pajtua jemi pajtua se ne komune kanë ndodhe komuna dmth pagesa mbi 30 dit janë jo ligjore e duhet me marr masa komuna pse me u vonu pagesa nëse u kry puna.

znj.Mirlinda Sadiku: Në vitin 2014 e ka bërë auditimin firma Dilloit tash e paska bërë Grandthorten na duhet me i besu dikujt auditimi është për me e majte një disiplinë financiare me dite ku po gaban ku po shkon paraja publike, të rekomandimet vetëm në tri rekomandime jeni pajtua, ndërsa me dhjet rekomandime të tyre nuk jeni pajtua qka e diskutoj kolegu Daut që disa në realitet egzistoj dhe qëndrojnë ato kualifikime që i ka bërë auditori, psh dobësinë në kontrollin menagjerial këtu nuk jeni pajtua e këtu hyn edhe prokurimi ndërsa te faqja tjetër jeni pajtua që ka dobësi sistematike në prokurim pikërisht është zyra ku behet implementimi i projekteve behet zgjedhja e operatorve ekonomik që kane mi kry punët në teren sidomos investimet kapitale mu ma merr mendja që të zyra e prokurimit të keni kujdes për arsyeje se pikërisht mos kryerja e detyrave dhe punëve ndaj operatorëve ekonomik shkakton masanej edhe qamje të asfalteve me na pik edhe kulmi në shkolla e shume problematika tjera dmth me një an je pajtua tjetrën nuk je pajtua a pikërisht në këtë është zyra e prokurimit, po ashtu edhe dosjet e personelit nuk janë ashtu si duhet.

z.Bekim Azizi: Drejtori i paraqiti shqetësimet e veta këtu shihen gjetjet 15 pika që i kane paraqit u diskutuan nga parafolësit, opinionin ka dal që nuk është mirë na presim që bile të përmisohen vërejtjet kur ti merrni, vërejtje ka pas na do ti besojmë auditorit mire po juve ju mbetet mu përmisu në gjetjet qka janë që vitin tjetër me dal raportet me të mira.

z.Bislim Bislimi: Auditimi është një proces shume serioz e kur dikush të thotë dy tri herë nuk jeni mirë duhet mu ndal me bisedua, ne te gjithë ja dojm të mirën komunës nuk e kemi që po e thojm por ja dojm të mirën, mu po me shqetësojnë me se shumti fakti e ku e përmendi znj.Mirlinda se prej 15 pikave vetëm 3 jemi pajtua, e nuk po me doket shume të rëndësishme në ato pika që jemi pajtua, dobësitë sistematike në prokurim është shume e vërtet, te borgjet e pa paguara jemi pajtua ndërsa të tjera pika nuk jemi pajtua e ato janë pika që më të vërtet janë shqetësuese.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Para tri katër dite ishe me një takim me drejtorët e auditimit me kryetarin e komitetit të auditimit dhe me kryetaret apo nënkryetaret e komunave dhe isha edhe unë mesin e shumeve ne diskutim un e kam theksuar edhe qet raport te cilin e kemi këtu, por një që me shti me dyshua u kane një prej rekomandimeve që thotë ta themeloni komitetin e auditimit e na këtë e kishim themelua në v. 2014 me vendim kur e kame pa këtë rekomandim tani nuk ju kame besua as këtyre tjerëve.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Ka të gjetura të arsyeshme por ka edhe shume te gjetura që nuk janë të arsyeshme por për opinionin publik bëjnë shqetësim e ne duhet me u mundu me tregu që nuk ka të bej shume me realitetin por ka të bej me disa sene ku auditorët e kane marr si baze.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ju faleminderit të gjithëve për kontributin që dhatë rreth kësaj informate

9. Informatë nga DKA

Ja kisha dhanë fjalën drejtorit rreth kësaj pike të rendit të ditës

z.Qahil Sinani: kjo informatë është kanë dashtë të jetë shumë më herët pas dihen arsyet e vonesës por un po ndalem te renovimi i shkollave nuk është 10 si është e cekur aty por është 15-të ngase prej 1 shtatori është punua prapë nëpër shkolla tjera , vetëm në shpjegim tash informaten e keni para jush për pyetje apo ndonjë sugjerim jam në dispozicion tu ndihmoj .

Kryesuesi . hapim debat rrethë kësaj pike të rendit të ditës .

z.Bekim Azizi: Unë isha lidh pak ndoshta nuk është e rëndësishme pas 2 muajëve të bisedohet mirëpo 14 vende i ka shpall po thotë 14 janë pranua na e dimi që ma shumë janë pranua nja 2-3 i ke pas edhe televizionet , isha lidh këtu ke shkruar janë bërë 4 emërime me kohë të caktuar në bazë të cilit ligj në bazë të cilit udhëzim ke bë emërime të mësimdhënëseve sepse emërime përpos drejtorëve të drejtorive që i banë kryetari i komunës emërim nuk mund me pas askund , çështja e drejtorëve të shkollave i ke 3-4 shkolla me ushtrues të detyrës e ki ligjin se ajo kohë sa duhet me zgjat ki që një vit me ushtrues të detyrës dhe vazhdon se prapë janë anulua konkurset mendoj se edhe këtu duhet me dhanë një shpjegim .

znj.Mirlinda Sadiku: Shumë mirë që pate durimin me pritë deri në fund i kam disa pyetje nëse ke përgjigjie sot mirë nëse nuk ke bën edhe në seancën tjetër : shkolla e Beguncës pse nuk është lëshua ende sipas një shkrimi i Plus Tv aty ekziston problemi në kyqjen në kanalizim , transferi i punëtorëve ka qenë njëri ndër premtimet e juaja që i keni dhënë kur je emëruar drejtor më intereson ta di pse në shkollën e Skifterait një punëtor teknik e ke transferu në shkollën gjimnaz për arsyet se njëri është i sëmur pse nuk është zvendësua ai për arsye se ka një vulim shumë të madh të punëve edhe ai punëtori teknik që është aty me të vërtetë nuk mund të ja dal mban me gjithë atë volum të punëve më intereson ta di pse ende nuk është zëvendësua , drejtor nëse të kujtohet sipas planit të prokurimit diku rreth 10 mijë euro janë pas nda për rekuizita sportive ndërsa shumë koleg të mijë ankohen që nuk kanë rekuizita sportive ,pse në shkollën dëshmoret e Vitisë nuk ka ujë të pijës kjo e dhënë është thënë nga ca mësuese që punojnë aty, shkolla në skifteraj e di që kam ngritë shumë zhurmë kam bërë për kulmin për me u rinovua të falënderoj publikisht që kem gjet mbështetje dhe përkrahje që po e bëni rinovimin e kulmit mirëpo e kam një shqetësim tjetër tash është punu në kohen kur është mbajtur mësimi a do të kishte mundësi të punohej të premtëve ,të shtunëve she të dielave se nëse vetëm një fëmij lëndohet ajo është shumë keq , më intereson ta di a është bërë pranimi teknik në shkollën e mesme Januz Zejnullahu e din qka ka ndodh me parket nuk po dua me hy ne detaje , si dhe më intereson ta di qysh vitin e kaluar ta kum pas bërë pyetje për paisjet e sallës së edukimit fizik Kryetari kishte qef me i than palestër sportive por palestër nuk është prapë insistoj se është sall e edukimit fizik edhe qka ndodhi me ministrinë e arsimit pse nuk erdhi ai tender a mos do të na ndodh sikur palestren sportive që na u premtua qe 6 vite , e fundit por hiq ma pak e rëndësishme pse nuk ka ende bursa për student z. Hasan Aliu ka pas than se është vit akademik ndahen e di që nuk është përgjegjësi e juaja këto ndahen prej zyrës së Kryetarit në kuadër të subvencionëve mirëpo studentat shumë kanë bërë pyetje pse nuk janë nda këto bursa .

z.Daut Xhemajli: Unë rreth kësaj informate nuk dua me fol por dua me fol për një shqetësim sipas meje që ja kam përmend edhe drejtorit puna është se na në shkollat tona nuk kemi mësim gjithë ditorë e tjera do kuzhina a do biznese që i keni hapur nëpër shkolla filllore në Viti u dashtë me gjet forma tjera me ndihmua e jo në shkolla me shtie e me bë kuzhinë e gatua edhe mu mbush erë shkolla e me u detyrua arsimtari mbledhni paret e sene tjera kjo për mua është çështje që nuk funksionon edhe është shumë problematike , e kam parasysh që janë shoqata të grave duhet me ndihmua por me i ndihmua ndryshe jo në këtë formë që sipas meje që është bërë se secila

shkollë nuk ka mundësi me bë kuzhinë plus asaj nxënsit ndihen të diskriminuar aty brenda është problematike e veçantë furnizimi kushtet higjiene sanitare në shkollën në Viti ju e dini qfar ere ka un mendoj se tu dashtë me ndihmua ndoshta shoqatat e grave i keni dhanë një dimension që un mendoj nuk është as ligjor as nuk mund të jetë human se ti pas parasysh nxënsit e tjerë në këtë aspekt un mendoj se duhet me rishqyrtua formën e furnizimit a formen e organizimit a këtë mundësi që ja kemi dhënë pavarësisht që kam respekt për për grupet e grave por kjo punë nëpër shkolla është delikate .

z.Bislim Bislimaj: Mendimi im edhe i subjektit që i takoj un në nivel të përgjithshëm arsimit qysh po e dimë është në ramje drastike aq se me gjithë këto mjete që kemi me gjithë këtë përparim teknologjik shkencor me pas kësi ramje e ka arsyen na po merrmi me do sene që nuk duhet me u merr drejtori e ka ba raportin ashtu si ka mund me bë dhe qysh ka ditë po un i kisha bë do vrejti fillimisht raporti është i shkurtër për këtë çështje na duhet me bë seancë ne vete o zotëri nëse domi me kontribue , pajtona me Dautin kur tha për kuzhinën kuzhina ose jepet fal ose bëhet me ndonjë mënyrë marveshje me komunë që me pagua pjesën për ata nxënës që nuk ka sepse është shumë e rënd kur dikush untë e dikush han , sa i përket renovimit të shkollave un e kam një vretje është dashtë me tregu kush ka kontribua në renovimin e shkollave nëse ka kaontribua komuna nëse ka kontribua fshati të ceket nëse ka kontribua ndonjë shoqatë duhet me u specifikua , un e di për një shkollë në fshatin Debelde është bërë me mjete të bamirësisë të disa vajzave dhe ajo është meritë plotësisht e tyre atë që e ka bërë komuna jonë e ka qu një bullduzher e ka qu për një orë ka punua 20 minuta është bërë një rremuj aty ka qenë edhe kryetari prezent janë ndrrua do fjalë ja kërcënime ki me më mbajt men kush jam un etj , krejt qka ma merr mendja mue qka është bërë mirë i kini shti do akraballëk të juajin në punë , a zavendsimi i lehonave nuk bëhet me emrim .

znj.Vjollca Kadolli- Halili: Unë jam prind që i kam dy fëmijë në atë shkollë po flas për shkollën Dëshmoret e Vitisë ajo qka dëgjova që nuk është bërë mirë që është hap ajo kuzhinë aty mendoj se është mendim shumë u gabuar një gjë e tillë është bërë edhe në Prishtinë ju ka dhënë ushqim në aspektin tjetër veq se është zvogëluar shkalla e papunësisë është edhe një plus i madh që disa nxënës që nuk kanë kushte janë liruar nga pagesa edhe një plus tjetër un mendoj se përveq që ju është dhënë aty ushqim fëmijet ikin prej rruge sepse gjithmonë e dim se në pushime dalin për të blerë diqka në shitore .

z.Sejdi Emini: Pajtohem plotësisht me Dautin dhe me Bislimin që ajo kuzhin nuk i përmbush kushtet edhe nuk kanë mundësi nxënsit për me pas para për me u shërbye aty është një far forme se ju mundësohet atyre të pasurve me pas disa privilegje por megjithatë me një far forme edhe në gjynah kemi me hy , nuk është pak 5 euro për dikanë që është pa punë dhe i ka 4 fëmijë aty un jam shumë i sigurt se mbi 50% nuk kanë me mund me u shërbye aty sepse nuk kanë kushte o duhet të gjithë me i mbulua o duhet mos me hy në gjynah , drejtor në shkollën ku punoj un dhe në shkollat tjera nuk është bërë dezinfektimi i shkollave nuk ka ardhur asnjë rekuizitë sportive siq tha Mirlinda , nuk ka ardhur asnjë detergjent un mendoj se këto janë gjëra elementare dhe nuk kushtojnë shumë nuk janë të pa përballueshme janë gjëra se duhet me pas shumë kujdes , te konkurset duhet me pas shumë kujdes nuk është hera e parë që po ngriten këto shqetësime un e kam përmend ma herët po e përmendi edhe tash 6 muaj para kohe dihet kush shkon në pension edhe kush po e zavendson duhet me pas kujdes me ja dhanë mundësinë mos mi shkel të tjeret se komuna nuk është vetëm e partisë është e gjithë qytetarëve përndaj duhet të hetë në shërbim të gjithë qytetarëve .

Znj. Gjylsime Qamili . un do të ndërlihem te ushqimi në shkolla që e marrin nxënsit un jam edhe prend i asaj shkolle që kam marr pjesë ne mbledhjen e prindërve aty ka pasur edhe kritere

të paraqitura që ata nxënës të cilët nuk kanë pasur mundësi të paguajnë kanë qenë të liruar për klas nga 2-3 nxënës kështu me sa kam informatë të gjithë nxënësit përfshihen krejt në ushqim .

z.Qahil Sinani: Unë mendova në fillim se nuk do të shkojmë kaq gjatë por nëse jeni ju të gatshëm e vazhdojmë sa të doni , të fshehta nuk ka asgjë krejtë mundesh me punua fshetë në arsim nuk mundësh pyetjet e shtrua nga ana juaj janë ndihmë për ne kuptohet subjektive dhe objektive , a ki të drejtë emërim shkurtë kamë të drejtë emërim , ngase nuk dihet kur smuret në konkurse të ndryshme krijohet lista pritëse për secilin profesion që shpallet konkursi që pranohen të tjerët pra lejohet emërim për një kohë sa të shpallen konkurset , te drejtoret e shkollave ka të drejtë deri një vit ushtrues detyre prandaj vet udhëzimi administrativ konkursi parë minimum duhet tre kandidatë ti plotësojnë kushtin nëse nuk i plotësojnë anulohet konkursi shkon në të dytin në të dytin dy dhe në të tretin shkon me një dhe për aty arsye ka ndodh kjo , shkolla nuk ka ujë të pijës të jesh e bindur Mirlind se tjetri menjëherë më ka thanë mos e dëgjo atë qka i ka thënë Mirlindës se ka ujë sa të dush edhe është ditë që ka me të thanë dikush më kanë telefonua edhe përgatitu edhe thuaj se ujë ka , te shkolla ne Skifteraj pyete mua më kanë pyet a të shkojmë me orar të shkurtuar apo ta lëm një ditë për me zëvendësua për të premtën i kam than i keni duart e lira si doni veproni nxënës mos të pengohen , shkolla teknike a është pranuar përpos sallës që ka me u plotësua me të gjithë inventarin sportiv , pajtona me Bislimin në Debolle e ka nderqë tri vajza kanë mbledhur një shoqatë sociale dhe kanë ardhur këtu në drejtori të arsimit dhe te kryetari në cilën shkollë po doni me rregullua na je kemi dhanë Debelldeun dhe janë investua mbi 20 mijë euro , rekuizita sportive i ke marr Mirlinda 1416 euro tash janë ardhur .

z.Sejdi Emini: Në shkollen tonë asnjëherë nuk kemi bërë politikë po kemi kërkuar kushte elementare për me i plotësua nevojat dhe mu kanë një proces mësimor qysh e meritojnë nxënësit edhe fshati është fakt se është punua janë ndreq rrugët është ndreq pllatoja është ndreq një fushë e sportit janë ndreq edhe banjët mirëpo është fakt se edhe komuniteti po punon me gjitha fuqitë e tyre që i ka në atë fushë që e keni ndreq ju ajo po rrethohet komplet me mjete vetanake me punë të qytetarëve janë ndreq tribunat është një punë që duhet me u vazhdua dhe mos me u ndal asnjë herë mos ta marrim atë që dikush po kërkon diqka e me ju gjuajtë të gjithë me i thanë jo valla po bënë politikë .

z.Bislim Bislimaj: Jemi ne rrjedha sa i përket ujësjellësit dhe ajo pjesë nata nuk ka ujë rregullit po ka me nderpreje edhe shkolla është me të na e dimë

znj.Mirlinda Sadiku: Drejtor, edhe muret paska vesh , ligji parauniversitar neni 37 .1.3 për DKA-në thotë DKA kujdeset inicion organizon krijimin e shërbimeve të nevojshme për nxënësit dhe mirëqenien e tyre ujin ambient banjesh shërbime shëndetësore shujta ditore , nëse me një shkoll po jepen një shujtë ditore ti po e shkel këtë ligj se po bënë diskriminim ndaj shkollave tjera , për Beguncë nuk mu përgjigje , për transferin e punëtorit të fsh Skifteraj nuk u përgjigje , edhe përgjigjen për bursat nuk mu përgjigje

z.Daut Xhemajli: Drejtor duhet me pas parasysh mua nuk më intereson se dikush e ka lukthin ma të fort dikush ma të but dikush e ndien dikush jo erën mua më intereson me pas rend dhe rregull aty në shkolla , nëse komuna konsideron se në ato kushte veq me ba me ndodh ndonjë e keqe duhesh me marr edhe përgjegjësi se aty ka edhe boca të gazit e sene që janë shumë të rrezikshme për fëmijët tanë .

z.Qahil Sinani: Sa i përket mjeteve higjienike sot kanë filluar të shpërndahen nëpër shkolla a kanë mbërri në Gushicë a jo nuk e di po prej nesrit besoj që i ke shkolla ka mbet keq vetëm për kanalizim , sa i përket kuririt është ardhur ma afër këtu sepse vynë sepse ky ka punuar me nxemjet, konkursi shpallet nesra për korir në Skifteraj.

Kryesuesi: Unë po mendoj se u shteren të gjitha rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndërsa tash kemi një deklaratë për të miratuar në emër të grupit

z.Daut Xhemajli:

Duke shprehur shqetësimin dhe pakënaqësinë e qytetarëve të Komunës së Vitisë për anashkalimin e Komunës tonë, për kyçje në autostradën Prishtinë – Shkup, në Gerlicë, Ne përfaqësuesit e partive politike dhe kandidatëve të pavarur në Kuvendin e Komunës së Vitisë, në emër të të gjithë qytetarëve:

Kërkojmë nga institucionet tona kompetente, Ministria e Infrastrukturës dhe Zyra e Kryeministrit, që qytetarëve tanë dhe kësaj Komune ti mundësohet kyçja në autostradën e lartcekur, në Gerlicë.

Këtë kërkesë e mbështesim, duke u bazuar në arsyeshmërinë ekonomike dhe politike, për të penguar anashkalimin e Komunës tonë, e cila do të dëmtojë rëndë perspektiven zhvillimore dhe do të rrit izolimin tonë, duke penguar rritjen ekonomike dhe politike të Komunës së Vitisë.

Kryesuesi: E hedhi në votim këtë deklaratë : konstatoj se me vota unanime miratohet kjo deklarat që tu ju adresohet nivelit qendrorë dhe organeve përkatëse.

Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
